



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Lipjanit*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqëse e ekipit *Sabile Musa* dhe Anëtare të ekipit *Besa Morina* dhe *Aida Podrimaj*, nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit *Bujar Bajraktari*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	20
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	22

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Lipjanit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi ynë është fokusuar në:



Konkluzionet

Konkluzioni për Pasqyrat Financiare Vjetore - Pasqyrat Financiare Vjetore janë përgatitur në harmoni me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik.

Konkluzioni për MFK - Komuna në përgjithësi kishte kontrole të mira në raport me obligimet statutorë. Megjithatë ekzistojnë disa dobësi të cilat duhet të adresohen. Sfidë për Komunën edhe më tutje mbetet pagesat me vendim gjykate, prokurimi, mallra dhe shërbime, paga e mëditje dhe menaxhimi i Llogarive të Arkëtueshme.

Konkluzioni në lidhje me rekomandimet e mëhershme - Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2018 ka arritur progres të theksuar duke marrë parasysh që disa rekomandimet janë zbatuar dhe pjesa më e madhe e tyre janë në proces të zbatimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i Pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Lipjanit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë, dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale, si dhe aranzhimet e qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Lipjanit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna në përgjithësi kishte kontrole të mira në raport me obligimet statutoare. Megjithatë ekzistojnë disa dobësi të cilat duhet të adresohen. Edhe më tutje mbeten sfidë pagesat me vendim gjykatë/përmbarimore, prokurimi, mallrat dhe shërbimet, pagat dhe mëditjet si dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme. Këto janë fusha ku nevojiten më shumë përmirësime në mënyrë që menaxhimi financiar dhe kontrolli të dëshmojnë proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	15,896,971	16,897,153	15,620,345	92	14,903,408	13,742,820
Granti i Qeverisë - Buxheti	13,744,547	13,744,547	13,294,779	97	13,352,789	11,687,679
Të bartura nga viti paraprak ³ -		987,665	726,878	74	330,177	590,347
Të hyrat vetjake ⁴	1,983,269	1,983,269	1,428,424	72	1,189,232	1,383,836
Donacionet e brendshme		748	0	0		
Donacionet e jashtme		125,916	117,508	93		80,958
Financimi nga Huamarrja	169,155	55,008	52,756	96	31,210	

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,000,182€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak dhe donacioneve. Ndërsa kishte zvogëlim të financimit nga huamarrja për 114,147€⁵.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Në vitin 2019, komuna kishte shpenzuar 92% të buxhetit final ose 15,620,345€, nivel i njëjtë me vitin 2018. Se si është realizuar buxheti në nivel të kategorive, janë dhënë shpjegimet me poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	15,896,971	16,897,153	15,620,345	92	14,903,408	13,742,820
Pagat dhe Mëditjet	9,280,000	9,339,179	9,096,502	97	9,036,804	8,650,049
Mallrat dhe Shërbimet	1,470,000	1,420,281	1,369,749	96	1,144,789	894,469
Shërbimet komunale	250,000	256,979	231,793	90	210,403	197,440
Subvencionet dhe Transferet	350,000	418,246	400,221	96	336,750	259,094
Investimet Kapitale	4,546,971	5,462,468	4,522,080	83	4,174,662	3,741,768

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti për paga dhe mëditje ishte rritur për 59,179€. Kjo ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak.
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 49,719€. Kjo ishte si rezultat i reduktimit të buxhetit nga Financimi nga Huamarrja.
- Buxheti për shërbime komunale ishte rritur për 6,979€. Kjo ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak.
- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte rritur për 68,246€. Kjo ishte si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak.
- Buxheti për Investime Kapitale ishte rritur për 915,497€, si rezultat i të hyrave, donacioneve dhe financimit nga huamarrja. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 83%. Në bazë të analizave që kemi bërë është vërejtur se mbi 2 milion euro apo 55% e mjeteve për këtë kategori janë shpenzuar në tre mujorin e fundit të vitit 2019. Kjo ka ndodhur si rezultat i vonesave në realizmin e punimeve.

⁵ Kjo shumë ka të bëjë me projektin Shëndetësia Kosovare (skema e pagesës së performancës), dhe e njëjta nuk ishte alokuar nga Ministria e Financave.

Çështja C1 - Keq-klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Bazuar në Udhëzuesin Administrativ NR. 19/2009 për planin kontabël për përdorim nga Organizatat Buxhetore – Kodi ekonomik nënkupton natyrën e shpenzimeve dhe të hyrave në regjistrin e buxhetit.

Thesari përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore kishte ekzekutuar pagesa në emër të komunës në vlerë 148,720€, për paga jubilarë dhe përcjellëse⁶ pas pensionimit, dhe për obligimet e bartura⁷ nga vitet 2011-2014 për paga të mësimdhënësive. Nga kjo shumë 45,974€ ishin paguar nga Investimet Kapitale, 97,982€ nga Mallrat dhe Shërbimet dhe 4,764€ nga Subvencionet e Transferet. Shpenzimet e tilla përveç që janë bërë nga kategoritë joadekuate të shpenzimeve, kanë shkaktuar edhe ngarkesë të buxhetit të komunës për shpenzimet shtesë për procedurat përmbartimore në vlerë 33,085€.

Kjo ka ndodhur në mungesë të aprovimit të buxhetit për këto pagesa dhe si rezultat i mungesës së mjeteve në kategorinë e pagave. Po ashtu Obligimet e bartura nga vitet paraprake kanë ndodhur shkaku i tejkalimit të numrit të punësuarve pa planifikim dhe nuk ka qenë e mundur të vendosen në listat e pagave për periudhën aktuale.

Ndikimi Shpenzimet për paga të mësimdhënësive nuk nxjerrin në pah elemente të shpenzimeve që do të plotësonin përkufizimin e kapitaleve, subvencioneve apo mallrave dhe shërbimeve. Prandaj kjo ndikon në mbivlerësim të këtyre kategorive ekonomike dhe nënvlerësim të pagave e mëditjeve. Rrjedhimisht kjo reflekton edhe me shpalosjen jo të duhur të informatave në PFV.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se janë evidentuar dhe përlllogaritur të gjitha rastet e stafit të pensionuar që pretendojnë kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse, në mënyrë që të planifikohet edhe buxheti për to. Po ashtu të gjitha obligimet duhet të paguhet me kohë dhe të shmangët mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore, kamatë vonesa dhe shpenzime të përmbartimit.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2019 ishin 1,888,072€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Gjithashtu Komuna kishte edhe të hyra indirekte nga gjobat e trafikut, gjobat e gjykatës dhe të hyrat nga pyjet në vlerë prej 260,496€.

⁶ Obligimi për këto pagesa ka rrjedhur si pasojë e "Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës".

⁷ Obligimet e bartura nga vitet 2011-2014 për paga të mësimdhënësive të cilët ende janë në marrëdhënie pune.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat tatimore	810,000	810,000	917,688	113	842,933	759,315
Të hyrat jo tatimore	1,173,269	1,173,269	970,385	83	961,652	851,703
Totali	1,983,269	1,983,269	1,888,072	95	1,804,585	1,611,018

Nga të hyrat vetanake të planifikuara, komuna ka realizuar 95%, vërehet një trend i rritjes nga viti paraprak. Nga këto tatimi në pronë përfshin 49% e gjithsej të hyrave, si kategori kryesore.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga dhe mëditje ishte 9,339,179€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,525 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,506. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 76⁸ punëtor të rinj. Kemi testuar 51 mostra për teste substanciale në vlerë 25,730€, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 - Pagesa e zyrtarëve të AME-së në mungesë të informatave për punën e tyre

Gjetja

Bazë për kompensimin e pagave dhe shtesave eventuale duhet të jetë kontrata e punës dhe dëshmitë se punonjësit kanë punuar gjatë muajit përkatës. Komuna kishte vazhduar të kompensoj 20 zyrtarë/zjarrfikës, në mungesë të informatave (kontratave dhe dëshmime të punës). Kjo ka ndodhur për shkak se këta zyrtarë, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si punëtorë të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme(MPB) dhe në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit, të gjitha kompetencat rreth menaxhimit, përfshirë menaxhimin e dosjeve të punëtorëve janë bartur nga komuna në AME respektivisht MPB, me përjashtim të buxhetit i cili ka mbetur tek komuna. Prandaj komuna kryen vetëm kompensimin e pagave dhe shtesave nga buxheti i saj. Pagat dhe shtesat për këta punëtorë gjatë vitit 2019 ishin 124,377€. Kjo çështje do të vazhdoj të përsëritet vit pas viti, derisa Ministria e Financave nuk ndërmerr hapa për bartjen e buxhetit në MPB.

Ndikimi

Pagesat për zyrtarët, në mungesë të kontratave dhe raporteve mujore për angazhimin, mund të rezultojë me pamundësinë për të justifikuar pagën dhe shtesat eventuale.

⁸ 7 nëpunës të rinj në Administratë, 4 në Shëndetësi dhe 65 në Arsimit.

Rekomandimi A1 Kryetari, deri në bartjen e buxhetit tek MPB-ja, duhet të kërkoj nga personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për t'u siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) në vitin 2019 ishte 1,677,260€, prej tyre ishin shpenzuar 1,601,542€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizim për zyre, furnizim të pajisjeve, shërbime kontraktuese tjera, pagesa me vendim të gjykatës, shpenzime komunale etj. Kemi testuar 31 mostra për teste substanciale në vlerë 228,227€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 – Vonesa në liferimin e mallrave/furnizimeve dhe mos zbatimi i ndëshkimeve

Gjetja Bazuar në kushtet e kontratës parashihen edhe ndëshkime/penale ndaj palëve në rast të mos-përmbushjes së obligimeve sipas orareve dhe specifikave të kontraktuara. Më tej, Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli/shërbimi, dhe pas pranimi të faturës bëhet pagesa.

Te kontrata “Furnizimi me inventar për nevojat e Komunës së Lipjanit” me datë 09.07.2019 në vlerë prej 7,483€, Operatori ekonomik nuk ka qenë i gatshëm për të realizuar gjithë furnizimin sipas kushteve të kontratës, si dhe menaxheri i kontratës nuk ka kërkuar nga departamenti i prokurimit që të zbatoj ndëshkimet për vonesa ndaj OE. Përveq kësaj, për të gjitha furnizimet nga kjo kontratë (gjithsej 18 fatura), fillimisht ishte bërë pranimi i mallit nga depoisti e pastaj, në kohëzgjatje prej një deri në dy muaj, pas pranimi të mallit ishte proceduar urdhër-blerja, pranimi i faturës dhe më pas ishte bërë pagesa.

Ndikimi Vonesa në liferimin e mallrave pengon zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara dhe efikasitetin në punë për arritjen e objektivave të përcaktuara, si dhe mos zbatimi i ndëshkimeve ndaj OE përveç ndikimit financiar, ndikon edhe në uljen e përgjegjësisë së OE që të përmbushin afatet e kontraktuara. Mos ndjekja e procedurave të duhura të kontrollit gjatë kryerjes së pagesave, është shmangie nga kërkesat ligjore dhe mund të rezultojë me pagesa potencialisht të parregullta.

Rekomandimi A2 Kryetari i komunës duhet të sigurohet që kontratat zbatohen sipas planit, dhe të aplikohen ndëshkimet në rastet e vonesave sipas kushteve të kontratës. Po ashtu Kryetari duhet të siguroj funksionimin efikas të mekanizmave dhe kontrolleve financiare, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 418,246€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 400,221€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me Subvencionet për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për Kulturë Rini dhe Sport, Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, për Komunitete dhe për subvencione nga zyra e kryetarit. Kemi testuar 8 mostra për teste substanciale në vlerë 123,098€ si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 – Mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve

Gjetja Bazuar në Rregulloren MF. NR. 04/2017, neni 6 – Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë Zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë ZKM.

Komuna e Lipjanit edhe pse me Buxhet të Kosovës ka parapa që gjatë vitit 2019 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve, nuk e ka përmbushur kërkesën ligjore për të plotësuar formularin e Planit Vjetor të Mbështetjes Financiare për të dërguar në ZKM-ZQM. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit ndërmjet Zyrës për Qeverisje të Mirë në ZKM që ka të bëjë me rëndësinë e këtij plani dhe Komunën që është përgjegjëse për të mbështetur kërkesat ligjore.

Ndikimi Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve që me kohë të parashikojnë të gjithë hapat që do të ndjekin në ofrimin e mbështetjes financiare publike, dhe me këtë rast të ndërmarrin të gjitha veprimet për ta implementuar thirrjen publike me sukses. Po ashtu do tu pamundësojnë OJQ-ve që të përgatiten për thirrjet publike.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, si dhe të dhënat që përfshihen në plan të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,462,468€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 4,522,080€. Ato kanë të bëjnë me ndërtim të rrugëve, ndërtim të kanalizimeve, mirëmbajtje investive, pagesa me vendim të Gjykatës etj. Kemi testuar 79 mostra për teste substanciale në vlerë 2,563,810 si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C2 - Vonesa në realizimin e punimeve

Gjetja Bazuar në kushtet e kontratës parashihet data e fillimit dhe përfundimit të gjitha punëve sipas ditëve dhe jo më vonë se data e fundit e përcaktuar sipas afatit të kontratës përkatëse.

Kontrata e nënshkruar në nëntor të vitit 2018 në vlerë prej 292,555€ për "Rregullimin e fushës së futbollit në Magure" kishte vonesa në realizimin e punimeve për dy muaj nga shtatori deri në nëntor 2019 për shkak të vështirësive të paraqitura gjatë gjurmimit dhe vonesave nga kompania projektuese për ndërhyrje të ndryshimit të projektit ekzistues.

Kontrata e nënshkruar në qershor të vitit 2019 në vlerë prej 129,798€ për "Ndërtimin e rrugës me trotuar, ndriçim publik në lagjen e Konjuhut rreth shtratit të Lumit Janjevka në Lipjan" kishte vonesa në realizimin e punimeve për pesë muaj nga gushti deri në dhjetor të 2019, për arsye se me projektin ekzistues nuk janë marr parasysh shpronësimet, nevojitet ri projektim i projektit.

Përveç kësaj komuna po përballet me moszbatim të planit dinamik për përfundim të punëve me kohë për shumicën e projekteve. Kjo është verifikuar nga dëshmitë për zgjatjen e afatit si shkak i vështirësive të paraqitura për të realizuar planin projektues.

Vonesat në realizimin e punimeve kanë ndodhur për shkak të defekteve të hartimit të projekteve nga kompania projektuese, pasi që nuk është përcaktuar saktë natyra dhe karakteristikat e performancës për punët e kërkuara.

Ndikimi Nënshkrimi i kontratave për punë pa përshkrimin e çartë të projektit ndikon në dështimet e kontraktorëve të cilët dështojnë në përmbushjen e obligimeve të tyre, mos përfundimin e punëve brenda afatit sipas planit dinamik, dhe ofrojnë mundësinë për shpenzime shtesë të projekteve.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurohet se asnjë dokumentacion i tenderit të mos lejohet pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit, i cili përcakton qartë natyrën dhe karakteristikat e performancës për punët e kërkuara, në mënyrë që të jetë i mundshëm realizimi i punëve sipas planit dinamik.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale, e paraqitur në PFV është 161,797,542€, pasurive jokapitale 433,259€, si dhe e stoqeve 41,718. Kemi testuar 28 mostra për teste substanciale në vlerë 1,543,949€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.3 Të Arkëtueshmet

Në PFV-të e vitit 2019 komuna ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 4,450,205€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë për objekte dhe parcela, leje afariste, qiraja për shfrytëzimin e pronës publike, për shfrytëzimin e hapësirave publike dhe shpronësime.

Çështja C3 – Menaxhimi i Llogarive të Arkëtueshme

Gjetja Llogaritë e arkëtueshme janë shuma të faturuara e të pa arkëtuara për shërbimet të cilat i ofron komuna për klientët e saj.

Për kundër faktit se komuna ka marr masa lidhur me inkasimin e llogarive të arkëtueshme duke dërguar vërejtje dhe lëndë në përmbarrim, rritja e tyre vit pas viti po ndodh kryesisht me tatimin në pronë. Kjo rritje ishte e ndikuar nga borgjet e ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në vlerë prej 660,659€, si dhe nga pronat të cilat janë të regjistruara në bazën e tatimit si prona të Lipjanit në vlerë prej 22,700€, mirëpo këto prona sipas ligjit të Kadastrit⁹ i takojnë komunës së Graçanicës. Bartja e pronave nga një komunë në tjetrën duhet të bëhet nga Departamenti i tatimit në pronë në MF. Kjo gjë ende nuk ka ndodhur edhe pas iniciativës nga zyra e tatimit në pronë të komunës.

Ndikimi Trendi i rritjes së vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme ndikon në përkeqësimin e performancës në inkasimin e borgjeve të përgjithshme të Komunës dhe nga ana tjetër trendi do të jetë negativ vit pas viti në të ardhmen. Po ashtu mos azhurnimi i të dhënave në sistem ndikon në informata jo të sakta sa i përket pronave brenda kufijve administrativ të Komunave.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të siguroj veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit të tyre. Po ashtu të intensifikoj dhe të risë nivelin e koordinimit me Departamentin e tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave për bartjen e pronave që nuk i takojnë komunës.

⁹ Sipas ligjit nr. 03/L-041 për Kufij Administrativ të Komunave neni (6) Zonat Kadastrale nr.34 (shtojca 1) të Kosovës përbehen nga zonat e caktuara të kadastrave. Komuna e Graçanicës në zonën e vet të kadastrave e posedon Suhadollin kurse në Lipjan figuron si Lagja e re e cila nuk është e shënuar që deri me tani nuk është bërë bartja nga një komunë në tjetër.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 132,946€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 136,557€, për të cilat komuna ishte në procese gjyqësore.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Pasqyra e detyrimeve kontraktuale ndaj furnitorëve sipas raportit të kontratave të realizuara në fund të vitit 2019, ishte 4,582,452€. Këto detyrime janë për kontratat/marrëveshjet e nënshkruara për të cilat obligimet paguhen në vitet në vijim.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Komuna ka të themeluar Komitetin e Auditimit në përbërje prej tre anëtarëve (dy të brendshëm dhe një të jashtëm). Gjatë vitit 2019 kishte mbajtur pesë takime, ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB për raportet e vitit 2019, dhe raporti i ZKA-së për vitin 2018.

NjAB kishte hartuar Planin Vjetor të vitit 2019 si dhe Planin Strategjik për vitet 2019-2021. Sipas planit vjetor të auditimit ishin planifikuar që të kryhen dhjetë auditime të rregullta dhe dy auditime me kërkesë të menaxhmentit. Gjatë vitit 2019 është përmbushur plani vjetor plotësisht, me fushëveprim për vitin 2018 dhe 2019. Secili raport i auditimit është përcjellë me një raport për rishikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga ana e NjAB-së.

Nga këto raporte kanë rezultuar 66 rekomandime, 36 prej tyre janë adresuar, 17 janë në proces të zbatimit dhe 13 kanë mbetur të pazbatuara ende.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Lipjanit ka rezultuar me 9 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të ndalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 3 rekomandime janë zbatuar, 3 ishin në proces të zbatimit dhe 3 rekomandime të mbyllura. Për një përkrahje më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve. Të gjitha shpenzimet duhet të buxhetohen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël dhe të ofrohen shpalosje të sakta për llogarit e arkëtueshme.	Edhe këtë vit kishte pagesa të ekzekutuara nga thesari me vendim gjykate për pagat e mësimdhënësve. Nuk kemi identifikuar LL/A të pa shpalosura në PFV (Shih C1)	Rekomandim në proces të zbatimit
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.	Realizimi i buxhetit për Investime Kapitale ishte 83%.	Rekomandim i mbyllur
3	Të hyrat	Kryetari duhet të kërkojë që gjatë procesit të regjistrimit dhe verifikimit të pronave të kushtohet kujdes ndryshimeve fizike që ndodhin dhe regjistrimit të pronave të reja po edhe ndryshimet në kategorinë e pronave dhe shfrytëzimin e tyre sipas kategorizimit ligjor. Kjo duke aplikuar anketim profesional dhe ndryshim me kohë të të dhënave në bazë të gjendjes	Nuk kemi identifikuar parregullsi në kalkulimin e të hyrave për vitin 2019.	Rekomandim i zbatuar

		faktike dhe rregullave në fuqi.		
4		Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e tatimit në pronë një plan të detajuar afatmesëm për të eliminuar dobësitë e identifikuar, dhe ta mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e këtij plani duke mundësuar eliminimin e mangësive dhe pasqyrimin e të dhënave të sakta për pronën e tatueshme.	Zyra e tatimit në pronë ka identifikuar prona të regjistruara si prona të Lipjanit që në fakt i takojnë Graçanicës. (Rekomandimi për këtë çështje është bartur tek LLA Shih C3).	Rekomandim i mbyllur
5		Kryetari duhet të kërkojë raport me shkrim nga Drejtoria e Urbanizimit për çdo tejkallim afati gjatë lëshimit të lejeve ndërtimore bashkë me arsyetimin për vonesat eventuale me qëllim të monitorimit dhe pajisjes me kushte/ leje ndërtimore brenda afatit të paraparë.	Nuk kemi identifikuar vonesa për vitin 2019.	Rekomandim i zbatuar
6	Subvencion e dhe Transfere	Kryetari duhet të monitoroj zbatimin e rregullores duke kërkuar nga drejtorit përkatëse/personat përgjegjës të sigurohen vetëm nëpërmes pranimit të dëshmimeve kthyesë, se mjetet kanë arritur qëllimin për të cilin janë ndarë. Në rast se përfituesit nuk arsyeton shpenzimin e subvencioneve apo përdorimi i mjeteve nuk është në përputhje me vendimin atëherë të ndërmerren hapat për kthimin e mjeteve në llogarinë e komunës.	Nuk kemi identifikuar lëndë pa raporte kthyesë për vitin 2019.	Rekomandim i zbatuar
7	Investimet kapitale	Kryetari të sigurojë se para inicimit të prokurimit për punë, projektet e hartuar paraprakisht janë të studiuara dhe përmbushin të gjitha kërkesat dhe qëllimin që duhet arritur, duke eliminuar mundësinë e punëve të pa parashikuara apo vonesave. Nëse paraqitet nevoja për procedura të aneks kontratave apo vazhdimin të afateve për përfundimin e punëve, aprovimi të behët vetëm nga personi përgjegjës apo Zyrtari kryesor administrativ.	Komuna për shumicën e projekteve po përballet me zgjatjen e afatit si shkak i vështirësive të paraqitura për të realizuar planin projektues. (Shih C2)	Rekomandim në proces të zbatimit

8	Çështjet e përbashkëta për M&Sh dhe IK	Përmes njësive kërkuese duhet të sigurohet se hartimi i specifikimit teknike me rastin e tenderimit janë të qarta dhe sipas nevojave reale dhe zyra e prokurimi të forcoj kontrollet duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione të përsëritura/jo të qarta.	Rekomandimi ka qenë për një kontratë specifike dhe nuk ka mundur të zbatohet.	Rekomandim i mbyllur
9	Të Arkëtueshmet	Kryetari të siguroj se zyra e prokurimit është njoftuar nga drejtoria për shërbime publike, për pengesat në implementimin e kontratës (apo vonesat në arkëtimin e mjeteve komform afateve të kontraktuara), në mënyrë që të merren masa për respektimin e tërësishëm të kontratës apo ndërprerjen e saj sipas dispozitave ligjore.	Komuna ka marrë masa lidhur me inkasimin e LLA duke dërguar vërejtje dhe lëndë në përmbardim. (Shih C3)	Rekomandim në proces të zbatimit
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj se janë evidentuar dhe përlllogaritur të gjitha rastet e stafit të pensionuar që pretendojnë kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse, në mënyrë që të planifikohet edhe buxheti për to. Po ashtu të gjitha obligimet duhet të paguhen me kohë dhe të shmangët mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore, kamatë vonesa dhe shpenzime të përmbardimit.		
2	Paga dhe mëditje	Kryetari, deri në bartjen e buxhetit tek MPB-ja, duhet të kërkoj nga personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për t'u siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet.		
3	Mallra dhe Shërbime	Kryetari i komunës duhet të sigurohet që kontratat zbatohen sipas planit, dhe të aplikohen ndëshkimet në rastet e vonesave sipas kushteve të kontratës. Po ashtu Kryetari duhet të siguroj funksionimin efikas të mekanizmave dhe kontrolleve financiare, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave.		
4	Subvencione dhe Transfere	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, si dhe të dhënat që përfshihen në plan të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar.		
5	Investime Kapitale	Kryetari duhet të sigurohet se asnjë dokumentacion i tenderit të mos lejohet pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit, i cili përcakton qartë natyrën dhe karakteristikat e performancës për punët e kërkuara, në mënyrë që të jetë i mundshëm realizimi i punëve sipas planit dinamik.		
6	Të Arkëtueshmet	Trendi i rritjes së vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme ndikon në përkeqësimin e performancës në inkasimin e borgjeve të përgjithshme të Komunës dhe nga ana tjetër trendi do të jetë negativ vit pas viti në të ardhmen. Po ashtu mos azhurnimi i të dhënave në sistem ndikon në informata jo të sakta sa i përket pronave brenda kufijve administrativ të Komunave.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pejtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përme: kësajshkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Imri Ahmeti.....

Kryetar i Komunës së Lipjanit

Data: 20/07 Lipjan

2020

